

Rezultatet e konsultimeve publike,

për projektligjin:

“Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar.

1. Titulli i projekt aktit

Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’, të ndryshuar.

Qëllimi i këtij projektligji është plotësimi i kuadrit ligjor për lejimin e ushtrimit të aktivitetit bujqësor përmes teknologjive inovative si; aeroponia, akuaponia dhe hidroponia për t’u zhvilluar në tokë bujqësore.

Në këtë mënyrë synohet të shfrytëzohen ato toka bujqësore, të cilat për shkak të cilësive jo të mira dhe kushteve jo të favorshme të terrenit, nuk kanë efektivitet në prodhimtarinë bujqësore, por krijojnë të ardhura nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja duke rritur konkurrencën dhe efektivitetin e prodhimit.

Përdorimi i këtyre teknologjive të reja dhe shfrytëzimi dhe vënia në efikasitet e tokave me pjellori të ulët do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor.

Pikat kryesore në të cilat bazohet projektligji janë:

- Zhvillimi i sektorit bujqësor, përmes përdorimit të teknologjive e sistemeve inovative;
- Shtimi i investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe për rrjedhojë rritja e prodhimit bujqësor e peshkimit;
- Vënia në efikasitet e tokave bujqësore me pjellori të ulët, të cilat aktualisht nuk shfrytëzohen.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë nga data 6.2.2025 deri në 6.3.2025. Në këtë afat përfshihet konsultimi përmes Regjistrit Elektronik. Gjithashtu pati komunikime edhe përmes postës elektronike, nëpërmjet së cilës pati dhe disa sugjerime. Numri i shikimeve në RENJKP ishte 230. Nuk ka patur komente në

Regjistër.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 ‘Për mbrojtjen e tokës bujqësore’”, të ndryshuar, ishin:

- konsultimi elektronik, përmes Regjistrat Elektronik, REKNJP, nga data 6.2.2025 deri në datën 6.3.2025;
- komunikimi përmes postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët interesuara që kanë dhënë komente/kontribut gjatë procesit të hartimit të këtij projekti, janë:

- Avokat Isuf Shehu “Shehu & Partners Law Firm”

Komentet janë dhënë nëpërmjet postës elektronike.

Projektligji u hartua nga grupi i punës, i ngritur në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Urdhër nr. 500, datë 2.7.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin dhe hartimin e ndërhyrjeve ligjore në legjislacionin e tokës” i ndryshuar, me përfshirje të punonjësve të drejtorive të bujqësisë, peshkimit, akuakulturës, bimëve etj, me qëllim krijimin e bazës rregullatore në legjislacionin e tokës për aplikimin e teknologjive në toka bujqësore.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komentet identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Sugjerim lidhur me shkronjën b), pika 5 e nenit 14, të projektligjit.	Sugjerimi për ndryshimin e gërmës b), pika 5 e nenit 14, ku është parashikuar që: “Ndërtimin e infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për prodhimin dhe transmetim dhe jo vetëm të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme agrifotovoltaike, si dhe ndërtimin e infrastrukturës për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme për tokat me bonitet 7 dhe 8”. Ndërkohë, që me ndryshimet të cilat synohen të kryhen nëpërmjet këtij projektligji parashikohet ndryshimi i bonitetit të tokës nga 7 deri në 10. Sugjerojmë se, nuk ka nevojë për këtë ndryshim pasi vetë ligji parashikon se strukturat që duhet të	Avokat Z. Isuf Shehu, (Shehu & Partners Law Firm)	I refuzuar	Ky sugjerim nuk qëndron, pasi gërma ”c” i referohet vetëm aktivitetit fotovoltaik dhe jo agrifotovoltaik, i cili, sipas përkufizimit të dhënë në ligj, është aktiviteti mbi tokën bujqësore, ku zhvillohen njëkohësisht prodhimi bujqësor në mënyrë të pandërprerë i kombinuar me ndërtimin, shfrytëzimin, operimin, prodhimin, tregtimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme

	instalohen për ushtrimin e aktivitetit të agrifotovoltaikut lejohen të ndërtohen në toka bujqësore me bonitet 9 dhe 10.			fotovoltaike (nga dielli).
Shkronja b), pika 5 e nenit 14 të projektligjit.	Ky ndryshim i bërë, nuk është në përputhje me pikën “d” të ligjit, në të cilën autorizohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë norma rregulluese për aktivitetin agrifotovolatik me akt nënligjor vetëm për tokat bujqësore me bonitet deri në 8.	Avokat Z. Isuf Shehu, (Shehu & Partners Law Firm)	I refuzuar	Sistemet agro fotovoltaike nuk mund të aplikohen në tokat me Bonitet 9 dhe 10 pasi këto toka nuk garantojnë nivelin minimal të prodhimit duke e bërë të pamundur realizimin e objektivit kryesor të sistemeve Agrofotovoltaik e që është vijueshmëria e prodhimit bujqësor. Kufizimet që kanë këto toka të kombinuara me ndryshimet mikroklimatike të shkaktuara nga instalimi i paneleve fotovoltaike

				çojnë në rendimente shumë të ulta duke mos përbushur objektivat që kanë këto sisteme që janë prodhimi bujqësor apo blegtoral si dhe energjisë.
--	--	--	--	--